

Të nderuar miq, akademikë dhe të tjerë të pranishëm,

E nderuara familja Gashi,

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë emrin, jetën, veprën dhe personalitetin e akademik Salih Gashit.

I përjetshëm qoftë kujtimi për akademik Salih Gashin!

Të nderuar miq!

Lajmi për ikjen në amshim të akademik Salih Gashit i tronditi të gjithë anëtarët e Akademisë, sepse bëhet fjalë për një shkencëtar të devotshëm, për një njeri të përkushtuar në punë shkencore dhe për një personalitet me kontribute të veçanta në fushën e shkencave të natyrës, më saktë të kimisë fizike.

Akademik Salih Gashi i takon gjeneratës së idealistëve, të cilët bënë punë të shkëlqyer, për të ndërtuar institucionet tona të arsimit të lartë dhe që këto institucione, përveçse në procesin arsimor, të përfshihen edhe në punë shkencore, jo vetëm duke zgjeruar njohuritë, por duke i bërë ato të zbatueshme në procesin e vështirë të përmirësimit të jetës së komunitetit.

Shkencëtarët si Sali Gashi e kishin ideal një shkencë funksionale, e cila komunikon lirshëm me arritjet më të avancuara të shkencës bashkëkohore, por që njëkohësisht është e aplikueshme për ambientin tonë, qoftë kur bëhet fjalë për klimën, për ujërat, për tokën, apo për mjedisin në përgjithësi.

Më lejoni të them me këtë rast, se unë personalisht, duke qenë në krye të projektit për Enciklopedinë shqiptare, kam humbur një bashkëpunëtor të vyer, i cili me urtësi, me përkushtim dhe me saktësi shkencore, bashkë me grupin e tij dhe në bashkëpunim të ngushtë me

redaksinë e mjedisit në Tiranë, bënë një fjalës pothuajse të mbaruar, krejtësisht të pranueshëm, duke zbatuar me saktësi kriteret e përcaktuara.

Kjo është një dëshmi, e cila bën të ditur se akademik Salih Gashi kishte sensin dhe kredon e shkencëtarit të vërtetë.

Pusho i qetë, koleg i nderuar, akademik Salih Gashi!